

# **AKT THEMELUES**

## **I SHOQËRISË TREGTARE**

### **"Kienex" SHPK**

Unë Ana Agim Troka, me nr. ID J56001033H, d.t. 01.10.1995, banuese në Rr. "Vellezërit Manastirli", Tiranë, mbështetur në Ligjin **Nr. 9723**, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" dhe në ligjin **Nr.9901** datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", sot me datë 20.04.2021, krijoj shoqërinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar "**KIENEX**", me aktin themelues të saj si vijon:

#### **FORMIMI**

##### **NENI 1**

Formohet shoqëria e quajtur "**KIENEX**" sh.p.k. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislaconit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do ti nënshtrohen legjisacionit ku do të ketë selinë.

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortaku themelues.

#### **SELIA E SHOQËRISË**

##### **NENI 2**


Selia e shoqërisë tregtare "**KIENEX**" sh.p.k. do të jetë: Rr. Frederik Shiroka, Pallati nr. 33, Njësia Administrative 7/ Tiranë. Ajo mund të çelë dhe seli të tjera , degë e filiale, përfaqësi dhe agjenci operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe me miratimin e organeve kompetente edhe jashtë vendit.

Shoqëria mund të ndryshoj selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendimin e ortakëve të saj.

Kapitali themeltar i Shoqërisë tregtare "**KIENEX**" sh.p.k. Do të jetë **1.000** (një mijë) lekë dhe do të përbehet nga kuota e ortakut themelues të shoqërisë. Kapitali përbehet nga 1 kuotë dhe vlera nominale e një kuote është e barabartë me **1.000** lekë. Kapitali Themeltar fillestar mund të shtohet sipas vendimit të ortakut themelues. Kapitali është tërësisht I shlyeshëm dhe I nënshkrueshëm.

##### **NENI 3**

Ortaku I vetëm duhet të bëjë përpjekje përritjen e potencialit ekonomik të shoqërisë, të ruajë konfidecialitetin e saj dhe të mos dëmtojë interesat e personave të tjera dhe të shoqërisë.



## **DREJTIM I SHOQËRISË**

### **NENI 4**

Shoqëria do të drejtohet nga 1 administrator Znj. Ana Troka, e cila është përfaquese ligjore e saj. Afati I emërtimit të administratorit është për një periudhë kohore prej 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

### **NENI 5**

Të ardhurat neto të shoqërisë I takojnë ortakut themelues të shoqërisë.

### **NENI 6**

Ortaku themelues ka të drejtë të emërtojë dhe administrator të tjerë të vlerave materiale të shoqërisë. Ai ka të drejtë të caktojë financier, likuidator për problemet e shoqërisë, si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë. Financieri nxjerr rregullisht treguesit financiare tre mujore, 6-mujore dhe vjetore, për aktivitetin e kryer të shoqërisë.

### **NENI 7**

Shoqëria ka vulën e saj në madhësi të zakonshme, me tekstin katërkëndore.

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

### **NENI 8**


Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen e të gjitha aktiviteteve që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperisë, duke u fokusuar kryesisht në:

1. Tregti me shumicë e pakicë të artikujve të ndryshem; materiale të pajisjeve elektrike dhe elektronike, pajisjeve industriale dhe elektroshëpiake, pajisjeve e sistemeve/impianteve të ftohjes dhe ngrohjes (kondicionimit) si dhe impianteve të tjera të çfarëdolloji, materiale ndërtimi, mallra industriale, lëndë të para, pjesë këmbimi për pajisje & makineri të ndryshme, etj.
2. Import - eksport i mallrave industriale, pajisjeve elektrike dhe elektronike, lëndëve të para, etj. ;
3. Transport mallrash; pajisje elektrike dhe elektronike, tregtim të materialeve te ndërtimit etj.

### **NENI 9**

Për kryerjen e veprimtarisë së saj shoqëria do të sigurojë mjetet e nevojshme dhe do të bashkëpunoj me persona fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj.

## **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**



## **NENI 10**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdolloj shkaku.

## **KAPITALI I SHOQËRISË**

## **NENI 11**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## **NENI 12**

Ky akt themelimi përpilohet në tre kopje me vlerë të barabartë, nga të cilat njëra depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit, njëra në zyrën e Tatimeve dhe kopja e tretë mbahet në dokumentat e shoqërisë tregtare "**KIENEX**" sh.p.k.

“  
“

Akti I themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË**

**"KIENEX" SH.P.K.**

**ANA TROKA**



*Ana Troka*  
**KIENEX SH.P.K.**